



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
PËRKTHIM B-A

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë / seminare

Viti / Semestri : Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë frënge ‘‘Gjuhë dhe Komunikim ‘‘

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:Ky modul propozon zhvillimin e një aftësie për të përkthyer tekste pragmatike nga gjuha frënge në atë shqipe. Pra, ai synon t’i njohë studentët e degës Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Francez (Viti i III-të) me elemente nocionore dhe gjuhësore të domosdoshme për të përkthyer si duhet tekstet pragmatike. Gjithashtu ai i njeh studentët me procesin e përkthimit dhe i familjarizon me mjetet e punës në përkthim

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të sigurojë një nivel të mjaftueshëm kompetencash përkthimore që kanë të bëjnë me kuptimin, riprodhimin dhe përkthimin e teksteve pragmatike .
- 2.Të përvetësojë kërkimin për qëllime dokumentuese mbi një temë të caktuar (tema e tekstit burimor).
3. Të ofrojë zgjidhje për probleme të ndryshme të përkthimit duke pasur parasysh sidomos qasjen interpretative.

Rezultatet e pritshme :

Në përfundim të lëndës studenti pritet të përvetësojë: - Kuptim të detajuar të një dokumenti të shkruar

- Thellim të njohurive mbi aktualitetin në vendet frankofone
- Zhvillim të aftësive në fushën e përkthimit me shkrim.
- Përdorim të CAT tools (Niveli 1)